



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK

TEPELENË

NR 1971/8 Prot

Tepelenë më, 01.09.2022

V E N D I M

Nr. 72, datë 31.08.2022

PËR

**“MIRATIMIN E MARRËVESHJES DHE PJESËMARRJEN E BASHKISË
TEPELENË NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME
QELLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM,
GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË
NDOTURA”**

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, VKM nr 302, datë 11.05.2022 “Për politikatat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura” Marrëveshjes për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve , me propozim të kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Marrëveshjen për krijimin e subjektit me kompetenca të ujësjellës kanalizimeve”, datë 22.07.2022 , lidhur ndërmjet Bashkisë Tepelenë dhe MIE dhe bashkive Gjirokastër, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull, Memaliaj,
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë “Tepelenë” UK, që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jete aksionare, të vijoje me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare “Tepelenë” UK për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe noterial me qëllim transferimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.
3. Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi Kryetari i bashkisë Tepelenë, dhe shoqëria aksionare e ujësjellës kanalizime Tepelenë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipa përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të ligjit 139/2015 , datë 17.12.2015 “Për vet Qeverisjen Vendore”

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Valbona Çela

Miratuar me 12 vota
Vota Pro 12
Vota Kunder -

KRYETAR
Elvis Shehu

